

MIKROTOPONIMET NË FSHATIN ORIZARE

MICROTOPONIMENTS IN THE VILLAGE ORIZARE

Jetmire ISUFI, Qendresa MUSTAFI, Majlinda KURTISHI

Shkolla e Mesme Teknike Komunale 'Nace Bugjoni'

Corresponding author: isufijetmire@gmail.com

Abstrakt

Çdo vendlindje ka zanafillën e vet, e cila u është lënë amanet të parëve tanë, që u përcollën brez pas brezi, për ta ruajtur çdo gjë të vleshme për nderin, burrinë e krenarinë. Përmes këtij punimi dëshirojmë t'ju tregojmë zanafillën, toponimin dhe mikrotoponimin e këtij fshati. Fshat që njihet përmes historisë, ku kanë lindur e rritur shumë figura të njohura për popullin shqiptar. Ky hulumtim fokusohet në analizën e toponimeve në fshatin Orizare, me qëllim të regjistrimit të familjeve dhe identifikimin e trashëgimisë kulturore e historike dhe rrugës së gjatë e të lavdishme që ka bërë ndër shekuj ky fshat i Komunës së Likovës, i cili shtrihej rrëzë maleve të Karadakut të Shkupit e Kumanovës. Hulumtimi identifikon gjithashtu ndikimin e faktorëve socio-kulturorë në emërtimin e vendeve dhe tregon rëndësinë e ruajtjes së këtyre emrave për trashëgiminë kulturore shqiptare të fshatit. Duke përdorur metoda të hulumtimit të fushës, u mbledhën të dhëna mbi emrat e vendbanimeve, rrugëve, dhe objekteve natyrore në këtë zonë. Toponimet analizohen për të zbuluar lidhjet e tyre me historinë, kulturën dhe identitetin e shoqërisë sonë. Rezultatet na tregojnë se ky territor është banuar pa asnjë ndërprerje nga popullata shqiptare pasardhës të dardanëve – Ilirë, që nga kohrat më të vjetra e deri tek ato modern, që këtë e dëshmon edhe Orizarja me historinë e saj të lashtë. Toponimet e fshatit Orizare janë pasqyra të historisë së saj, duke reflektuar ngjarje historike, karakteristikat gjeografike dhe traditat e kombit shqiptar. Ky studim kontribuojë në kuptimin e rëndësisë së toponimeve si elemente të identitetit lokal dhe ofron rekomandime për ruajtjen dhe promovimin e kulturës në Orizare.

Fjalë kyçe: Toponime, zanafilla, mikrotoponime, fshat, Orizare

Abstract

Each birthplace has its origin, which was entrusted to our ancestors, who were passed down from generation to generation, to preserve everything valuable for honor, manhood and pride. Through this paper, we would like to show you the origin, toponymy and microtoponymy of this village. The village known through history, where many figures known to the Albanian people were born and raised. This research focuses on the analysis of toponyms in the village of Orizare, with the aim of registering families and identifying the cultural and historical heritage and the long and glorious path that this village of Likova Municipality, which was located at the foot of the Karadak mountains, has made over the centuries of Skopje and Kumanovo. The research also identifies the influence of socio-cultural factors on the naming of places and shows the importance of preserving these names for the Albanian cultural heritage of the village. Using field research methods, data was collected on the names of settlements, roads, and natural objects in this area. Toponyms are analyzed to discover their connections with the history, culture and identity of our society. The results show us that this territory has been inhabited without any interruption by the Albanian population, descendants of the Dardanians - Illyrians, from the oldest times to the modern ones, which Orizarja also proves with its ancient history. The toponyms of Orizare village are reflections of its history, reflecting historical events, geographical characteristics and traditions of the Albanian nation. This study contributes to the understanding of the importance of microtoponyms and toponyms as elements of local identity and offers recommendations for the preservation and promotion of culture in Orizare.

Keywords: Toponyms, origins, microtoponyms, village, Orizare

Hyrje

Ky punim i dedikohet rrugës së gjatë e të lavdishme që ka bërë ndër shekuj fshati Orizare i komunës së Likovës, i cili shtrihet rrëzë maleve të Karadakut të Shkupit e Kumanovës. Vendlinda jonë Orizarja ka një histori të gjatë, të lashtë e shumë të pasur, me shumë vuajtje e peripeci, gjithmonë e përcjellur me aq krenari brez pas brezi. Deri para një kohe nga gjeneratat më të vjetra u lanë shumë amanete që u përcollën brez pas brezi, për ta ruajtur çdo gjë të vlefshme për nderin, burrinë e krenarinë. E di dhe jam i vetëdijshëm se ne shumë pak dimë për të mos thënë aspak nuk dimë për vendlindjen tonë dhe të parët tanë që jetuan shekuj me rradhë denbabaden në këto troje tona arbërore. Banorët e vjetër të saj kanë qenë të fisit Dardan. Për këtë flasin dëshmi të shumta shkencore. Këtë mendim e pohojnë edhe autorët sllav studiues të kësaj treve, si J.Haxhivasiloviqi, J. Trifunofski etj., por duke i shtuar edhe atë si gjithë territoreve tjera dardane – ilire, edhe ky rajon është pushtuar nga romakët dhe se popullsia e tij është asimiluar prej tyre. Qëllimi i kësaj teze është të nxirret përfundimi se në kohën e ardhjes së sllavëve në këtë zonë nuk kishte shqiptarë të vjetër, pasardhës të ilirëve dardanë dhe se ajo popullsia u vendos në shekullin XVII – XIX e inkurajuar nga turqit osmanë. E vërteta është se ky territor është banuar pa asnjë ndërprerje nga popullata shqiptare pasardhës të dardanëve – Ilirë, që nga kohrat më të vjetra e deri tek ato modern, që këtë e dëshmon edhe Orizarja me historin e saj të lashtë.

Fshati Orizare

Orizarja është fshat fushor (rrafshinor), por është fshat që prek edhe rrëzat e maleve të Karadakut. Shtrihet në zonën hipsografike prej 500 metrash lartësi mbidetare në fshat. Fshatin e ndanë në dy pjesë “Përroi i Madh”, i cili kur bie shi është mjaft i rrezikshëm për arat e fshatit. Në të kaluarën e hershme Orizarja e vjetër ka qenë e vendosur nga ana e majtë të fshatit Sllupçan, në vendin e quajtur “Sinanka” (Arat e Sinanit). Sipas disa gojëdhënave thuhet se gjatë luftimeve Orizarja e vjetër u dogj tërësisht, kjo mund të ketë ndodhur gjatë Luftës Austro-Turke të vitit 1689-1690, ose më herët gjatë sundimit romak, dhe pas një kohe u vunë themelet e Orizares së re në vendin ku ekziston sot. Toka e Orizares së vjetër është e shtrirë deri tek “Përroi i Sllupçanit”. Orizarja përmendet shumë herë që në shekullin XIV, viti 1332, por edhe shumë më herët. Nëpër Orizare që e ndan fshatin në dy pjesë kalon edhe rruga e asfaltuar që e lidhë këtë fshat me qytetin e Kumanovës dhe fshatrat e tjerë që lidhet edhe me qytetin e Shkupit. Ndërsa edhe nga ana e fshatit Sllupçan, Vaksincë, Llojan, Miratoc lidhet me Preshevën.

Toponimi Orizare

Ky fshat në popullatën vendase dhe në trevën e saj të gjërë ndeshet me emrin Orizare, Olizare, Alizare, që paraqet një formim gjuhësor i shqipes që rrjedhë nga fjala “oriz” dhe prapashtesën – ‘are’. Fshati Orizare është në tokë të rrafshët, dikur ishte i pasur me ujë, prandaj në të kaluarën do të jetë mbjellur oriz në këtë trevë, prej nga edhe e mori fshati emrin që e ka sot. (Mr. Mehmeti Halimi “Toponimet si dëshmi e autoktonisë së popullsisë shqiptare në Maqedoni”, libri “Shqiptarët e Maqedonisë, Orizarja këtë emër e merr, sepse toka e këtij fshati mbillej oriz. Fara e orizit mbjellur për rreth lumit dhe atë në 4 vjet një herë, kështuqë banorët e Orizares ishin të liruar nga tatimet e rregullta dhe të çrregullta shtetërore vetëm për shkak se ishin orizaras. Banorët e fshatrave Sllupçan, Opajë, Rëzhanovci dhe Reçicë që ishin në këtë rajon gjatë kohës së regjistrimit ankoheshin duke thënë se orizarasit mbjellin më shumë farë orizi se sa ishte e paraparë. Orizi mund të jetë i kultivuar aty deri nga vitet 1600-1650. Vija me të cilën janë ujitur arat e mbjellura me oriz është quajtur “Vijë e Orizishtes” që sot e kësaj dite mban të njejtin

emër. Uji për uitje është marrë nga lumi i Likovës. Kjo vijë ka kaluar nëpër Orizare që nga Likova dhe ka vazhduar deri në fshatin Tabanoc.

Regjistrimi i familjeve në fshatin orizare

Gjatë regjistrimit të vitit 1579 Orizarja ka numëruar 41–45 familje, ndërsa kryeplaku (udhëheqësi) i fshatit ishte Arslan Hizri. Se Orizarja është fshat i njohur dhe i lashtë dëshmohet në shumë raste dhe atë me fakte të vërtetuara historike. Gjatë luftërave Turko- Austriake, kur komandën udhëheqëse pas tërheqjes së Austriakëve nga Shkupi e mori Herçogu Hollshtajn, kjo ndodhi pas vdekjes së Pikollomonit me 09.11.1689. Defterët, ose librat e regjistrimit, që u hartuan gjatë shekujve të parë të sundimit Osman për detyrimet ekonomike të popullsisë së nënshtruar, janë burime me vlerë historike, sepse përveç të dhënave për sundimin e marrëdhënieve ekonomike ofron edhe të dhëna për strukturën etnike të popullsisë. Këto të dhëna antroponomike dhe toponomastike që sjellin këto defter tregojnë qartë se edhe shqiptarët e Orizares gjatë shekullit XV- XVI banonin në trojet e tyre. Ky element shqiptar ishte I pranishëm edhe në fshatin Orizare. Këto pohime vërtetojnë edhe dëshmitë antroponomike si dhe me fillimin e islamizmit të shqiptarëve në trojet që edhe sot banohen prej tyre. Shumë prej tyre që ruhen edhe sot nga mikrotoponim ia në fshatrat e kësaj treve, por edhe të fshatit Orizare japin prova të pakundërshtueshme se këto vise ishin të banuar me shqiptarë, që para ardhjes së sllavëve dhe se popullsia Ilire- Shqiptare i kishte bërë ballë sundimit të huaj shekullor.

Familjet- lagjet e orizares

Fshati Orizare më parë ka qenë me më pak lagje, sepse ka qenë edhe më i vogël, por me rritjen e tij rriten edhe lagjet. Lagjet nuk janë të ndara tani sipas fisit, por sipas emërtimeve të një të pari të lagjes në një kohë të caktuar. Fshati Orizare dikur ka pasur edhe çifligun e vet në fshatin Dumanoc. Në Orizare më shumë ka dominuar fisi Arnor, Golaj, Gash, Krasniq, Thaç, Berishë etj. Si në tërësi të rajonit të Kumanovës ashtu edhe atë të Likovës ashtu edhe në fshatin Orizare një rëndësi të madhe do të paraqes edhe leksiku patronomik tek mbiemrat familjar të lloj-llojshëm të cilat janë krijuar më herët edhe të cilat janë trashëguar brez pas brezi e deri më sot. Tek një numër mbiemrash edhe pse kanë lidhje të ngushta të gjakut dhe fisit këto familje hasim mbiemra të ndryshëm. Këto emra personal dhe familjar u përkasin sferave të ndryshme të leksikut të shqipes. **Arnorët – Cumelët:**

Lagjja e Arnorëve – Cumelëve, është njëra ndër fiset dhe lagjet më të mëdha të fshatit Orizare. të dhënave të ndryshme historike na sjellin në konkludim se fisi Arnor ka etimologjinë e emrit Arbër apo Arbnor. Fisi i Arnorëve përmendet në shumë vende të banuara me shqiptar në trojet e tyre. Më vonë nuk do të përmendet nga brezat më të reja ky emër i këtij fisi dhe i kësaj lagjeje duke u zëvendësuar me emrin e një të pari të këtij fisi siç do emërtohet më vonë kjo lagjeje si lagjeje e Cumelëve. Fjala – Cumel, rrjedh prej fjalës cub-e diçka që është e prerë ose e shkurtuar- cubel. Njeriu i parë i Cumelëve mund të ketë qenë cubel, me dorë të prerë, të shkurtuar. E ky thuhet se ishte Halil Cubeli (Cumeli). Familja e lagjes së Cumelëve më vonë do të zgjerohet dhe sipas emrit të njërit nga anëtarët e familjes do të mbajnë mbiemrat dhe do të zgjerohen.

Shabedinët:

Shabedini në moshën 12 vjeçare do të dërgohet për shkollim në Turqi. Atje ai I ka kryer tre fakultete: akademinë ushtarake, drejtësinë dhe teologjinë. Edhe kjo familje ka të shpërngulur në Turqi dhe të migruar në Kumanovë dhe Shkup. Djemtë e Shabedit kanë qenë: Qazim Efendiu, Qamil Efendiu dhe Besim Efendiu. Edhe Qamili Shabedini ka qenë njeri shumë i aftë

dhe intelektual, atdhetar dhe ka qenë pjesëmarrës i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në trevën e Karadakut (1980 – 1912). Ishte një atdhetar dhe intelektual i madh, kishte marrë pjesë në hapjen e shkollave shqipe së bashku me Jashat Erebarën dhe shumë intelektuale tjerë shqiptarë. Edhe Qazim Shabedini ka qenë intelektual, shpërngulet në Turqi. Kjo familje sot jeton në Orizare, Kumanovë, Shkup dhe Turqi. I takojnë fisit Berishë. Njëherit vendosen në Likovë e pastaj në Orizare.

Jasharët:

Jasharët janë të shpërngulur nga një fshat në drejtim të Surdulicës, rrethi I Vranjës, i banuar tërësisht me shqiptarë, gjatë vitit 1877/78. Sipas rrëfimeve të fshatarëve më të moshuar, Hasan Spahiu ishte pronar i shumë tokave në Vranjë. Jashati ishte djali i Hasan Spahisë. Jashati kishte pasur tre djem dhe ata ishin: Kurishi, Murati dhe Mehmeti. Edhe kjo familje ka të migruar në Shkup.

Bellancët e lagjes së epërme: kjo familje është e ardhur në Orizare prej fshatit Bellanoc. Bellancët e epërm në këtë fshat kanë ardhur aty nga viti 1900. Janë të vendosur në lagjen e epërme të fshatit.

Emërtimet në fshat

Sot qendra “Juria” e fshatit është rregulluar, për rreth ka: kafiteri, çajtoje, shitore, park dhe mu në mes të qendrës gjendet përmendorja e heroit kombëtar të këtij fshati Ismet Jashari – Komandat Kumanova. Në qendër të fshatit shumë më herët gjendej një çezme që e mbajnë mend vetëm pleqtë më të mocëm. Atë e kishte ndërtuar Saqip Emiri dhe quhej “Çezma e Axhës Saqip”. Çezma kishte dy çepe për ujë dhe një koritë dhe gjendej në qendër të fshatit. Burimi i saj ishte që nga mali i Orizares. Tani as gjurmët e kësaj çezme nuk ekzistojnë.

Disa emërtime: Lumi i Likovës (Penda e Likovës): Në afërsi të fshatit Orizare kalon lumi i fshatit Likovë, që burimin e këtij lumi gjendet diku në brigjet e Karadakut gjegjësisht në fshatin Brezë. Orizarasit shumë herë ishin angazhuar që tokat e tyre të ujin për të prodhuar rendimentemë të larta. Këtë ua mundësoi lumi i Likovës, kështu që bërën “vijën e ujit” dhe sollën ujin në arat e tyre. Falë këtij uji, orizarasit një kohë të gjatë ishin të njohur si kultivues të orizit.

Varresat e epërme (varrezat e lagjes së Cumelëve)

Në këto varreza janë të varrosur banorët e vdekur të lagjes së “Cumelëve”. Karakteristikë e veçantë tek “Varrezat e Epërme” është edhe kjo: në hyrje të varrezave, afër rrugës kryesore gjendet një varr që dallohet nga varret tjera dhe quhet “Varri i Sulltan Këzit” apo “Varri i Vajzës së Sulltanit”, por disa e quajnë edhe “Guri i Xhenazës”. Thuhet se gjatë luftës Austro–Turke, austriakët të kenë gjuajtur tek ushtria turke nga mali Isarit që gjendet në territorin e fshatit Sllupçan, me top ushtarak dhe e kanë vrarë vajzën e sulltanit, e cila është varrosur aty. Thuhet se ajo është e vrarë në kohën kur ka qenë duke shikuar më dylbi në drejtim të Isarit. Kjo duhet të ketë ndodhur gjatë vitit 1689. Thuhet se ajo ka ra dëshmore (shehide), ndërsa mbi varrin e saj natën janë parë xixa, shkëndija dritësh. Në këtë varr deri para ca kohësh janë sjellur për shërim fëmijesh të vejël (fohnje) që kanë pasur shumë vajë (të qarë). Fëmijët një kohë janë vendosur të pushojnë mbi varr dhe pastaj u është ndalur vaji.

Përfundimi

Moti kohë kam pasur një motiv të brendshëm që vazhdimisht më ngacmonte shpirtin, një frymëzim i zjarrtë për të hedhur dritë mbi kujtesën time të kahershme për vendlindjen time. Arsyeja pse e zgjedha që të shkruaj për mikrotoponimet e fshatit tim është se emërtimet që janë bërë të fushave, maleve, çezmeve, varrezave dëshmon se ky fshat ka një histori të lashtë dhe të dhënat historike dëshmojnë se ky territory ka qenë i banur me shqiptar. Të gjitha traditat, zakonet, gjuha dhe të gjitha emërtimet që janë bërë në fshat janë ruajtur me një fanatizëm dhe janë përcjellur brez pas brezi deri në ditët e sotshme.